

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI**

**L I G J**

**Nr.8618, datë 14.6.2000**

**PËR TELEKOMUNIKACIONET NË REPUBLIKËN  
E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

K R E U I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Ky ligj rregullon veprimtarinë e telekomunikacioneve në Republikën e Shqipërisë dhe synon të mbrojë interesat publikë dhe të krijojë një mjedis rregullator transparent, që ndihmon nxitjen e investimeve dhe konkurrencën e lirë.

Neni 2

Përkufizime

Për zbatimin e këtij ligji termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. sAdministrimi i spektrit është veprimtaria teknike, administrative dhe juridike për një përdorim të frytshëm të spektrit të radiofrekuencave në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare.
2. sAksesi në Internett është shërbimi, i cili mundëson aksesin në rrjetin dhe shërbimet e Internetit.
3. tInterkoneksiont është lidhja fizike dhe logjike e rrjeteve publike të telekomunikacioneve që përdoruesit e shërbimeve publike të telekomunikacioneve të një operatori publik telekomunikacionesh, të lidhen ose të komunikojnë me përdoruesit e

shërbimeve publike të telekomunikacioneve të një operatori tjetër publik telekomunikacionesh.

4. tLinjë me qirat është një shërbim telekomunikacioni, i cili ka të bëjë me vendosjen nga operatori publik i telekomunikacioneve, i linjave të palëvizshme, të përhershme, permanente ose virtuale, ndërmjet pikave fundore të rrjetit për përdorim vetëm nga një përdorues individual, kundrejt një pagese.

5. sMinistërt është Ministri që mbulon sektorin e telekomunikacioneve, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Postë-Telekomunikacioneve.

6. sNumëror telefonik është botimi i librit të numrave telefonikë të abonentëve të një operatori publik, si dhe i adresave të tyre.

7. sNumrat janë sekuenca karakteresh që shërbejnë për adresim në rrjetet e telekomunikacioneve.

8. sOperator i pavarur i telekomunikacioneve është subjekti, të cilit i është dhënë një licencë për të ngritur një rrjet të pavarur telekomunikacionesh për realizimin e komunikimeve vetëm brenda një ose disa grupeve të mbyllura përdoruesish.

9. sOperator publik i telekomunikacioneve është subjekti, të cilit i është dhënë licencë për të ndërtuar e shfrytëzuar një rrjet publik telekomunikacionesh dhe/ose për të ofruar shërbime publike telekomunikacionesh.

10. sOperatort është subjekti, të cilit i është dhënë licenca, në bazë të dispozitave të këtij ligji.

11. sOrganizëm me fuqi të ndjeshme në tregt është subjekti që autorizohet të ofrojë rrjete publike telefonike dhe/ose shërbime publike telefonike, të qëndrueshme (të palëvizshme) dhe/ose të lëvizshme dhe/ose linja me qira në Republikën e Shqipërisë, i cili është përcaktuar si i tillë nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve.

12. sPajisje fundoret është çdo pajisje në përdorim të abonentit që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthoraz në një pikë fundore të rrjetit të telekomunikacioneve, për të realizuar telekomunikacionet. Pajisja fundore mund të lidhet me rrjetin nëpërmjet përcjellësve metalikë, optikë ose nëpërmjet kabllave koaksiale dhe, në këtë rast, quhet e palëvizshme. Nëse pajisja lidhet me rrjetin me mjete radioelektrike, ajo quhet e lëvizshme.

13. sPajisje radiokomunikacionit janë pajisjet për transmetimin, emetimin ose marrjen e radiovalëve për qëllime radiokomunikimi.

14. sPajisje telekomunikacionit është çdo mjet teknik (linjë transmetimi, pajisje komutimi dhe çdo pajisje tjetër, e nevojshme për të siguruar funksionimin e rrjetit të telekomunikacioneve) që shërben për realizimin e telekomunikacioneve.

15. sPërdorues është çdo person fizik ose juridik, që përdor shërbime publike telekomunikacionesh.

16. sPika fundore të rrjetit janë të gjitha lidhjet fizike, së bashku me specifikimet e tyre teknike, të cilat janë pjesë e rrjetit publik të telekomunikacioneve dhe shërbejnë për aksesin në këtë rrjet publik dhe realizimin e komunikimit nëpërmjet tij.

17. sPlan kombëtar i radiofrekuencave është dokumenti që përcakton brezat e radiofrekuencave për shërbime të ndryshme dhe vendos kushtet bazë për caktimin dhe përdorimin e radiofrekuencave, me qëllim përdorimin me efektivitet të spektrit të radiofrekuencave dhe shmangien e interferencave.

18. sRadiokomunikacion është telekomunikacioni i realizuar nëpërmjet radiovalëve.

19. sRregullimt janë masat e ndërmarra për të arritur objektivat e shprehur në nenin 3 të këtij ligji dhe për të siguruar përdorimin e frytshëm dhe pa interferenca të radiofrekuencave.
20. sRrjet i pavarur ose i brendshëm telekomunikacionesht është një rrjet telekomunikacionesh i caktuar për përdorim nga një ose disa persona fizikë a juridikë, që përbëjnë një ose disa grupe të mbyllura përdoruesish dhe për të realizuar vetëm komunikime brenda grupit.
21. sRrjet i telekomunikacioneve është tërësia e mjetet teknike (linja transmetimi, pajisje komutimi dhe çdo pajisje tjetër, e nevojshme për të siguruar funksionimin e rrjetit të telekomunikacioneve), të cilat shërbejnë për realizimin e telekomunikacioneve.
22. sRrjet publik i telekomunikacioneve është një rrjet telekomunikacionesh i përdorur, ndërmjet të tjerash, për ofrimin e shërbimeve publike të telekomunikacioneve.
23. sShërbim global i komunikimeve vetjake të lëvizshme është shërbimi telefonik i lëvizshëm, i cili realizohet nëpërmjet lidhjes së drejtpërdrejtë të pajisjes fundore, të lëvizshme, të përdoruesit me një sistem satelitor. Njihet edhe me emërtimin GMPCS.
24. sShërbim informacionit është dhënia e informacionit për përdoruesit e shërbimeve të rrjetit publik, i cili ofrohet me kërkesën e çdo personi, nëpërmjet rrjetit të telekomunikacioneve.
25. sShërbim publik i telekomunikacioneve është ofrimi që i bëhet publikut, për qëllime fitimi, i telekomunikacioneve, si dhe linjat me qira që u ofrohen palëve të treta.
26. sShërbim publik telefonik i lëvizshëm tokësor është shërbimi publik telefonik, i ofruar për përdoruesit, nëpërmjet një rrjeti publik telekomunikacionesh, pikat fundore të të cilit nuk janë në vendndodhje të qëndrueshme, duke i dhënë mundësi përdoruesve të komunikojnë brenda zonave të mbuluara nga ky shërbim, pavarësisht nga vendndodhja.
27. sShërbim publik telefonik i qëndrueshëm (i palëvizshëm) është shërbimi publik telefonik, i ofruar për përdoruesit, pajisjet fundore të të cilëve lidhen në pikat fundore me vendndodhje të qëndrueshme të rrjetit publik të telekomunikacioneve.
28. sShërbim publik telefonik është ofrimi ndaj publikut, për qëllime fitimi, i transportimit dhe komutimit të drejtpërdrejtë e në kohë reale të zërit, ndërmjet pikave fundore të rrjetit publik me komutim, duke i dhënë mundësi çdo përdoruesi të përdorë pajisjet e lidhura në këto pika fundore rrjeti, për të komunikuar me një pikë tjetër fundore.
29. sShërbim universal është një grup minimal i përcaktuar shërbimesh, të një cilësie të caktuar, i cili është i mundshëm për të gjithë shtetasit, pavarësisht nga pozicioni gjeografik dhe që ofrohet me çmime të përballueshme.
30. sShërbimi i transmetimit të të dhënave është ofrimi tregtar për publikun, i transportimit të drejtpërdrejtë të të dhënave, ndërmjet pikave fundore të rrjetit publik me komutim, duke i dhënë mundësi çdo përdoruesi të përdorë pajisjet e lidhura me një pikë të tillë fundore rrjeti, për të komunikuar me një pikë tjetër fundore.
31. sShërbimi me vlerë të shtuart është shërbimi në kohë reale i bazave të të dhënave videotekst, shërbimet e informacionit, përpunimi në largësi i të dhënave, posta elektronike, shërbimet transaksionale, konvertimi i shpejtësisë dhe i protokolleve.
32. sShërbimi radio i kërkimit të personit (paging) është veprimtaria tregtare e komunikimit të teksteve të shkurtra ose e sinjalizimeve akustike, nëpërmjet një terminali të veçantë, të lëvizshëm.

33. sSistem radiokomunikacionit është një ose disa dhënës ose marrës, ose një ndërthurje dhënësish e marrësish, përfshirë pajisjet e tyre ndihmëse, të nevojshme në një vendvendosje të caktuar për realizimin e një shërbimi radiokomunikacioni ose të një shërbimi radioastronomik.

34. sSpektri i radiofrekuencave është spektri që përfshin frekuencat prej 9KHz deri në 400 GHz.

35. sStandard ndërkombëtar është standardi i miratuar nga organizmat ndërkombëtarë, si ITU-ja, CEPT-ja, ku aderon Republika e Shqipërisë.

36. sTelekomunikaciont është emetimi, dhënia ose marrja e mesazheve në formën e shenjave, të zërit, të figurave ose të tingujve, nëpërmjet rrjeteve të telekomunikacioneve, por që nuk përfshin transmetimin radioteleviziv.

37. sTransmetim radiotelevizivt është shpërndarja e sinjaleve radiotelevizive për publikun, nëpërmjet transmetimit të valëve elektromagnetike, në hapësirë ose në një infrastrukturë kabllore.

Neni 3

Objektivat afatgjatë të politikës

Objektivat afatgjatë të politikës së zhvillimit të telekomunikacioneve në Republikën e Shqipërisë janë zhvillimi i harmonizuar i infrastrukturës së telekomunikacioneve dhe shtrirja graduale e saj në të gjithë vendin, me qëllim që të arrihet:

- a) akses në shërbimet telefonike me çmime të përballueshme;
- b) gamë e gjerë shërbimesh moderne, e cila të jetë e përdorueshme nga e gjithë popullsia e Republikës së Shqipërisë;
- c) liberalizim i tregut, konkurrencë shërbimesh dhe mundësi zgjedhjeje për përdoruesit ;
- ç) mbrojtje më e mirë e përdoruesit.

KREU II

ROLI I SHTETIT NË TELEKOMUNIKACIONE

Neni 4

Përcaktimi i politikave të zhvillimit dhe të rregullimit të sektorit të telekomunikacioneve

Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit, përcakton strategjinë e zhvillimit të telekomunikacioneve brenda kuadrit të vendosur nga ky ligj.

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve mbikëqyr zbatimin e kuadrit rregullator të përcaktuar nga ky ligj dhe nga politikat e Këshillit të Ministrave.

Neni 5

Vendimet për zbatimin e politikës së zhvillimit të telekomunikacioneve

Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit dhe në këshillim me Entin Rregullator të Telekomunikacioneve dhe shoqatat e konsumatorëve, ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për përmbushjen e objektivave të politikës së zhvillimit të telekomunikacioneve.

## Neni 6

### Drejtoria e Përgjithshme e Postë-Telekomunikacioneve

Drejtoria e Përgjithshme e Postë-Telekomunikacioneve është person juridik, publik, buxhetor dhe punon për përmbushjen e objektivave të strategjisë së telekomunikacioneve. Drejtoria e Përgjithshme e Postë-Telekomunikacioneve varet nga Ministri, i cili ka në kompetencë veprimtarinë në fushën e telekomunikacioneve.

## Neni 7

### Kompetencat e Drejtorisë të Përgjithshme të Postë-Telekomunikacioneve

Drejtoria e Përgjithshme e Postë-Telekomunikacioneve ka këto kompetenca:

- a) Harton projektaktet ligjore e nënligjore për zhvillimin e sektorit të telekomunikacioneve.
- b) Bashkërendon punën për hartimin e planit kombëtar të radiofrekuencave dhe punon për harmonizimin e këtij plani me politikat ndërkombëtare të zhvillimit të spektrit të radiofrekuencave.
- c) Bashkërendon punën për realizimin e nevojave të institucioneve shtetërore, si të Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Rendit Publik, Shërbimit Informativ të Shtetit, etj.
- ç) Mbledh e përpunon të dhëna statistikore nga të gjithë operatorët publikë të telekomunikacioneve në vend.
- d) Ndjek zbatimin e detyrimeve për sektorin e telekomunikacioneve, që rrjedhin nga marrëveshjet, konventat ose protokollat dypalëshe dhe/ose shumëpalëshe, ku Republika e Shqipërisë është palë.
- dh) Bashkërendon shërbimet kombëtare të radiondërlidhjes bregdetare.
- e) Mbështet veprimtarinë e radioamatorizmit në Republikën e Shqipërisë.
- ë) Bashkëpunon me organet e pushtetit vendor për çështje të telekomunikacioneve.
- f) Bashkërendon punën për zhvillimin e burimeve njerëzore në sektorin e telekomunikacioneve.
- g) Harton plane zhvillimi të telekomunikacioneve dhe i paraqet Ministrit rekomandimet përkatëse.

## Neni 8

### Enti Rregullator i Telekomunikacioneve

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve është organi rregullator i telekomunikacioneve, i cili mbikëqyr kuadrin rregullator të përcaktuar nga ky ligj dhe nga politikat e zhvillimit të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

Neni 9

Kompetencat e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve ka këto kompetenca:

- a) Nxist zhvillimin e sektorit të telekomunikacioneve, duke zbatuar procedurat e licencimit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.
  - b) Jep licencat në bazë të përcaktimeve të këtij ligji dhe mbikëqyr respektimin e kushteve të licencave.
  - c) Rregullon interkoneksionin e rrjeteve të telekomunikacioneve.
  - ç) Kontrollon cilësinë e shërbimeve të ofruara nga operatorët dhe kërkon që ato të përputhen me standardet e caktuara.
  - d) Kujdeset që konkurrenca ndërmjet operatorëve të telekomunikacioneve të mbështetet në parimet e transparencës, të mosdiskriminimit dhe të ndërshtëmërisë.
  - dh) Harton dhe miraton planin kombëtar të numëracionit dhe siguron zbatimin e tij.
  - e) Mbron interesat e përdoruesve të shërbimeve të telekomunikacioneve nga praktikat e pandershme të operatorëve.
  - ë) Verifikon njëlllojshmërinë e pajisjeve të importuara të telekomunikacioneve dhe bën përshtatjen e atyre që prodhohen në vend.
  - f) Harton dhe miraton kushtet dhe standardet teknike për rrjetet e telekomunikacioneve, në përputhje me rekomandimet ndërkombëtare.
  - g) Cakton radiofrekuencat për çdo përdorues civil, me përjashtim të operatorëve radio dhe televizivë, duke dhënë licencën përkatëse dhe merr masa për mënjanimin e interferencave, gjetjen e shkeljeve dhe mënjanimin e përdorimeve abuzive të frekuencave.
  - gj) Mbikëqyr bazueshmërinë me kërkesat e këtij ligji të tarifave të ofruara nga operatorët publikë të telekomunikacioneve.
- Aktet e nxjerra prej Entit Rregullator të Telekomunikacioneve botohen në Buletinin e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.

KREU III

RRJETET DHE SHËRBIMET E TELEKOMUNIKACIONEVE

Neni 10

Rrjetet e telekomunikacioneve

Rrjeti publik i telekomunikacioneve ndërtohet për të mbështetur shërbimet publike të telekomunikacioneve dhe funksionon si rrjet mbarëkombëtar, pa dallim, për të gjithë

përdoruesit, i hapur për të gjithë operatorët dhe i integruar në rrjetin ndërkombëtar, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Rrjetet e pavarura të telekomunikacioneve ndërtohen dhe mirëmbahen nga subjekte të licencuara, për të plotësuar nevojat e tyre. Lidhja me rrjetin publik të telekomunikacioneve bëhet në marrëveshje me operatorët.

Vendosja e rrjeteve të reja të telekomunikacioneve bëhet nga subjekte të licencuar, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

## Neni 11

### Mbrojtja e rrjetit nga dëmtimet

Operatori i telekomunikacioneve mban dokumentacion të plotë e të saktë, për rrjetin e vet. Me kërkesë zyrtare, operatorët i japin njëritjetrit dhe sipërmarrësve të tjerë të dhëna për pjesë të këtij rrjeti, për të shmangur dëmtimin e rrjetit nga punimet nëntokësore ose ndërtimore ose nga ndikimet e mundshme elektrike, që shkakton vënia në punë e pajisjeve të vendosura pranë rrjetit të telekomunikacioneve.

## Neni 12

### E drejta e përdorimit të pronës publike e private

Operatori publik i telekomunikacioneve ka të drejtë të përdorë tokë, troje ose objekte në pronësi të shtetit, përfshirë ndërtesat e kanalizimet e ndërtuara mbi ose nën to, të drejtat nënujore dhe ato të hapësirës ajrore, rrugët, liqenet, pyjet etj., për vendosjen e pajisjeve të telekomunikacioneve, si dhe për mirëmbajtjen e tyre.

Para fillimit të punimeve në trojet ose në mjediset me pronësi publike, operatorët publikë të telekomunikacioneve duhet të njoftojnë autoritetet përkatëse dhe të respektojnë të gjitha kërkesat e arsyeshme, të vendosura nga to. Mosmarrëveshjet ndërmjet operatorit publik të telekomunikacioneve dhe autoritetit përkatës zgjidhen nga gjykata.

Operatori detyrohet të shfrytëzojë pronat e mësipërme, në përputhje me ligjet që mbrojnë mjedisin dhe, me përfundimin e punimeve, kur është objektivisht e mundur, detyrohet ta kthejë mjedisin në gjendjen e mëparshme.

Operatori publik i telekomunikacioneve përdor tokën, trojet dhe objektet pronë private, në marrëveshje me pronarët e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kur nga vendosja ose mirëmbajtja e pajisjeve të telekomunikacioneve dëmtohet prona ose ndryshon funksioni i saj, operatori publik i telekomunikacioneve detyrohet të shpërblejë dëmin, sipas legjislacionit në fuqi.

## Neni 13

### Detyrimi i operatorit për mirëmbajtje

Operatori i telekomunikacioneve detyrohet të mbajë pajisjet e telekomunikacioneve në gjendje të mirë pune, duke respektuar kushtet teknike dhe standardet përkatëse.

Gjatë përmbushjes së detyrave për mirëmbajtjen e pajisjeve të telekomunikacioneve, punonjësit e autorizuar nga operatori kanë të drejtë të hyjnë në pronat publike dhe private, për të kryer punimet e nevojshme, si dhe për të vënë shenja të ndryshme, që tregojnë praninë e objekteve të telekomunikacioneve.

Për të siguruar funksionimin normal të pajisjeve të telekomunikacioneve, operatori ka të drejtë të presë pemët, shkurret, degët e rrënjët që rrezikojnë pajisjet e mësipërme, në përputhje me kërkesat e akteve ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast se pronari privat bëhet pengesë, operatori u drejtohet organeve kompetente, të cilat marrin masat e nevojshme brenda 15 ditëve.

Neni 14

Mbrojtja e rrjetit nga dëmtimet e të tretëve

Për të parandaluar dëmtimin e mundshëm të rrjetit ekzistues të telekomunikacioneve, çdo person fizik ose juridik që kryen punime ndërtimi e gërmimi, përpara fillimit të punimeve detyrohet të njoftojë operatorët publikë të telekomunikacioneve.

Në rast se punimet në rrjetin ekzistues të telekomunikacioneve duhet të kryhen në mënyrë të pashmangshme, të gjitha shpenzimet për mbrojtjen, shmangien ose dëmtimin e këtyre rrjeteve të përballohen nga subjekti që kryen punimet.

Mosmarrëveshjet ndërmjet palëve zgjidhen nga gjykata.

Neni 15

Detyrime për sipërmarrësit ndërtues

Në rastet e ndërtimit të godinave për qëllime biznesi ose të godinave të banimit, sipërmarrësit ndërtues detyrohen të ndërtojnë rrjetin e brendshëm telefonik.

Neni 16

Standardet e pajisjeve të telekomunikacioneve

Në rrjetin publik të telekomunikacioneve mund të vendosen vetëm pajisje, të cilat kanë karakteristika teknike sipas standardeve të harmonizuara e të miratuara nga organizmat ndërkombëtarë të telekomunikacioneve, ku aderon Republika e Shqipërisë.

Neni 17

Organizmi me fuqi të ndjeshme në treg

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve përcakton nëse një operator është organizëm me fuqi të ndjeshme në treg. Një operator vlerësohet me fuqi të ndjeshme në treg nëse ai kontrollon 25 për qind të tregut të zonës gjeografike, ku ky organizëm është i autorizuar të veprojë.

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve mund të vlerësojë si organizëm me fuqi të ndjeshme në treg edhe një operator që zotëron më pak se 25 për qind të tregut përkatës, si dhe mund të mos ta vlerësojë si organizëm me fuqi të ndjeshme në treg, një operator që zotëron më shumë se 25 për qind të tregut përkatës. Në raste të tilla, në arritjen e këtyre përcaktimeve, Enti Rregullator i Telekomunikacioneve mban parasysh aftësinë e organizmit për të ndikuar në treg, të ardhurat e tij në raport me madhësinë e tregut, kontrollin mbi mjetet e aksesit të përdoruesit fundor dhe përvojën e operatorit në ofrimin e produkteve dhe të shërbimeve në treg.

Neni 18

Detyrat e operatorit për ofrimin e shërbimit

Operatori publik i telekomunikacioneve, në zonën ku ushtron veprimtarinë, ka këto detyra:

- a) Tru ofrojë shërbime dhe pajisje telekomunikacioni përdoruesve dhe operatorëve të tjerë, pa bërë favorizime ose diskriminim, kur është organizëm me fuqi të ndjeshme në treg.
- b) Të vijojë trafikun drejt/nga operatorët e tjerë dhe të mirëmbajë e të zhvillojë rrjetet publike të telekomunikacioneve që administrojnë.
- c) Të bashkëveprojë me operatorët e tjerë publikë për:
  - (i) këmbimin e ndërsjellë të informacionit dhe bashkërendimin e të dhënave teknike për bashkëpunimin e rrjeteve të tyre;
  - (ii) kryerjen e matjeve të parametrave të shfrytëzimit të sistemit;
  - (iii) harmonizimin e sistemeve të mirëmbajtjes, bashkërendimin e punës për mirëmbajtjen e sistemeve;
  - (iv) riparimin e defekteve.
- ç) Të kontribuojë në çështjet e mbrojtjes të rendit publik dhe të sigurimit kombëtar.
- d) Të zbatojë kushtet e licencës.

Neni 19

Detyrimi i operatorit për të informuar

Operatori publik i telekomunikacioneve detyrohet t'i japë të dhëna statistikore Drejtorisë së Përgjithshme të Postë-Telekomunikacioneve dhe Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.

Lloji i të dhënave, afatet dhe mënyra e dërgimit të tyre përcaktohen përkatësisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Postë-Telekomunikacioneve dhe nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve.

## Neni 20

### Detyrimi i operatorit për mbrojtjen kombëtare dhe rendin publik

Operatori publik i telekomunikacioneve i jep përparësi çështjeve të mbrojtjes kombëtare dhe të rendit publik, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe me kushtet e licencës.

## Neni 21

### Marrëdhëniet e punës

Marrëdhëniet e punës, ndërmjet operatorit publik të telekomunikacioneve dhe punonjësve të tij, rregullohen nga dispozitat ligjore të punës.

## Neni 22

### Ruajtja e fshehtësisë

Operatori publik i telekomunikacioneve duhet të marrë masa ndaj sistemeve të telekomunikacioneve dhe të përpunimit të të dhënave për të mbrojtur sekretin e telekomunikacioneve dhe të të dhënave vetjake, si dhe për të ndaluar aksesin e paautorizuar në sistemet e telekomunikacioneve dhe të përpunimit të të dhënave. Operatori publik i telekomunikacioneve, të autorizuarit, si dhe punonjësit e tij detyrohen të ruajnë e mbrojnë të dhënat dhe fshehtësinë e komunikimeve që kryhen nëpërmjet rrjetit dhe shërbimeve të tij, si gjatë periudhës së licencës, ashtu edhe pas mbarimit të saj. Operatori publik mund të marrë dijeni për mesazhe ose të dhëna të transmetuara nëpërmjet rrjetit të tij, vetëm në masën që i nevojitet për të kryer detyrën në sigurimin e shërbimeve të telekomunikacioneve. Ndalohet marrja, regjistrimi, publikimi dhe përdorimi i të dhënave dhe i mesazheve që janë transmetuar nga rrjeti i telekomunikacioneve dhe që nuk janë për publikun.

## Neni 23

### Sekreti profesional

Ndalohet riprodhimi i sinjaleve që nuk përfshihen në kushtet e licencës, përdorimi i tyre për qëllime të tjera, deklarimi i ekzistencës ose dhënia e tyre personave të paautorizuar.

## Neni 24

### Detyrimi për dhënie informacioni autoriteteve shtetërore

Pavarësisht nga neni 22 i këtij ligji, për kryerjen e hetimeve penale, operatori publik i telekomunikacioneve detyrohet të mbajë skedarët e të dhënave për përdoruesit e shërbimeve të tyre, kur një gjë e tillë kërkohet nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve ose nga çdo autoritet tjetër, i përcaktuar në Kodin e Procedurës

Penale. Skedarët duhet të përmbajnë vetëm hollësi për numrat e thirrur nga përdoruesi, datën dhe kohën e çdo thirrjeje edhe në rastet kur numri nuk është i publikuar në numërorin telefonik.

Këta skedarë duhet të vihen në dispozicion autoriteteve përkatëse, në formë elektronike, në përputhje me udhëzimet e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.

Neni 25

Përgjimi i komunikacioneve

Pavarësisht nga neni 22 i këtij ligji, operatori publik i telekomunikacioneve duhet t'i lejojë organet e autorizuar, me ligj të veçantë, për të përgjuar, regjistruar dhe riprodhuar komunikimet e kryera në rrjetin e tij, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale dhe me rregulloren e nxjerrë në mbështetje të nenit 57.

Pajisjet e vendosura ose të lidhura me rrjetin e një operatori publik telekomunikacionesh për përgjimin e bisedave telefonike duhet të jenë kompatibël me sistemin e telekomunikacioneve dhe nuk duhet të krijojnë interferenca me sisteme të tilla.

Neni 26

Detyrimet parësore të operatorit në raste të veçanta

Operatori publik i telekomunikacioneve detyrohet që, me rrjetet dhe shërbimet e tij, të përballojë nevojat e shtetit në rast emergjence, fatkeqësish natyrore dhe kur e kërkojnë interesat e mbrojtjes kombëtare e të rendit publik.

Detyrimet e mësipërme mund të përcaktohen në kushtet e licencës ose mund të vendosen, rast pas rasti, nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve.

Operatorët e telekomunikacioneve bashkëveprojnë ndërmjet tyre dhe me organizatat qeveritare, ndërqeveritare dhe joqeveritare për përdorimin e burimeve të telekomunikacioneve për lehtësimin dhe kapërcimin e fatkeqësive:

- a) duke vendosur pajisje të komunikimit tokësor dhe satelitor për parandalimin, mbikëqyrjen dhe sigurimin e parandalimit të shkatërrimeve natyrore, fatkeqësive në përgjithësi e atyre shëndetësore në veçanti;
- b) duke shpërndarë njoftime për shkatërrimet natyrore, fatkeqësitë shëndetësore ndërmjet organizmave të lidhura me to dhe përhapjen e të dhënave në publik, veçanërisht në bashkësitë që rrezikohen më tepër;
- c) duke siguruar ndihmë të menjëhershme të telekomunikacioneve, për lehtësimin e pasojave të fatkeqësive;
- ç) duke vendosur dhe vënë në punë shërbimet e telekomunikacioneve fleksible, që përdorin organizatat humanitare.

Për lehtësimin e përdorimit të mësipërm, operatorët e telekomunikacioneve mund të lidhin marrëveshje të veçanta dhe të vendosin pagesa të veçanta ose të nënshkruajnë shtesa në marrëveshjet ekzistuese.

Neni 27

## E drejta për pajtim

Cilido ka të drejtë të pajtohet dhe të përdorë shërbimet publike të telekomunikacioneve, në rast se ato janë të pranishme përreth zonës ku ka vendbanimin ose ushtron veprimtarinë.

## Neni 28

### Të drejtat dhe detyrat e përdoruesve

Çdo përdorues i shërbimeve telefonike publike ka të drejtë të përdorë rrjetet publike të telekomunikacioneve, për trafikun kombëtar e ndërkombëtar, në kushte jodiskriminuese, objektive dhe transparente, me përjashtim të rasteve kur diktohet ndryshe nga mundësitë e kufizuara të mjeteve të operatorit publik.

Përdoruesit e shërbimeve telefonike publike kanë të drejtë të marrin shërbim të rregullt, të frytshëm dhe të pandërprerë.

Përdoruesit e shërbimeve telefonike publike kanë të drejtë të kërkojnë sqarime e të bëjnë ankesa për shërbimin që u ofrohet, të cilat duhet të shqyrtohen e të zgjidhen në mënyrë të frytshme.

Përdoruesit e shërbimeve telefonike publike i përdorin shërbimet kundrejt pagesës.

Përdoruesit e shërbimeve telefonike publike detyrohen të kujdesen dhe të mirëmbajnë pajisjet e tyre fundore për të mbrojtur rrjetin.

## Neni 29

### Kontrata e pajtimit

Për përdorimin e shërbimeve telefonike publike, operatori i shërbimeve telefonike publike lidh kontratën me përdoruesit.

Kontrata tip, që lidhet ndërmjet operatorit dhe përdoruesit, duhet të mbështetet në parimin e barazisë kontraktore të palëve. Ajo hartohet nga operatori dhe miratohet nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve.

## Neni 30

### Faturimi

Operatori i shërbimeve telefonike publike duhet të garantojë saktësi në vënien e tarifës dhe në faturimin për shërbimet e kryera prej tij. Për të vërtetuar saktësinë e tarifës dhe të faturimit, operatori i shërbimeve telefonike publike duhet të ruajë kopje të faturave, të paktën deri në dy vjet.

Faturimi bëhet në mënyrë periodike, sipas përcaktimit në kontratë dhe përdoruesi i shërbimit njoftohet për detyrimin financiar të tij, brenda një muaji nga data e faturimit.

Operatori i shërbimeve telefonike publike i jep pa pagesë çdo përdoruesi të tij një faturë, e cila përmban elementet bazë që lejojnë verifikimin dhe kontrollin e tarifës e të

faturimit. Elementet bazë të kësaj fature përcaktohen nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve.

Me kërkesë të përdoruesit, operatori i shërbimeve telefonike publike duhet të sigurojë shërbimin me fature të hollësishme, kundrejt një pagese të arsyeshme.

Neni 31

Trajtimi për shërbime të ndryshme nga ato të telefonisë publike

Kur Enti Rregullator i Telekomunikacioneve përcakton se një operator ka fuqi të ndjeshme në treg për shërbime të ndryshme nga ato të telefonisë publike, ai ka të drejtë të vendosë nëse ato shërbime u nënshtrohen, pjesërisht apo tërësisht, kërkesave të neneve 28, 29, 30 të këtij ligji.

Neni 32

Detyrimi i operatorëve për mbrojtjen e shëndetit dhe të mjedisit

Operatorët e telekomunikacioneve detyrohen të marrin të gjitha masat për mbrojtjen e shëndetit të përdoruesve të rrjeteve të telekomunikacioneve dhe të personave që janë të ekspozuar ndaj këtyre rrjeteve, si dhe mbrojtjen e mjedisit.

Neni 33

Detyrimi për të siguruar cilësinë e shërbimit

Operatorët publike të telekomunikacioneve duhet të sigurojnë përdoruesve të tyre shërbime të standardeve cilësore, të miratuara në të gjithë territorin ku ushtrojnë veprimtarinë e tyre.

Në raste të veçanta, përdoruesi mund të lidhë kontratë me operatorin për cilësi me të lartë shërbimi, kundrejt pagesës.

Neni 34

Detyrimi për botimin e numërorëve

Operatori, i cili zotëron pjesën më të madhe të tregut të telefonisë së palëvizshme, detyrohet të botojë numëror shërbimi, të paktën një herë në vit. Operatorët e tjerë publike të telekomunikacioneve duhet të marrin masat për tri dhënë këtij operatori të dhënat e duhura për përdoruesit e shërbimeve të tij, me qëllim që të dhënat e numërorit të përgatitur për botim të pasqyrohen saktë. Numërori i shërbimit përmban edhe telefonat publikë, me monedhë ose me kartë të parapaguar.

Përdoruesit kanë të drejtë të publikohen të dhënat në numërorë, të verifikojnë dhe, nëse është e nevojshme, të korrigjojnë të dhënat ose të kërkojnë heqjen e tyre nga numërorët.

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve duhet të sigurojë që operatori, i cili ofron shërbimin e përcaktuar në paragrafin e parë të këtij neni, të respektojë parimet e mosdiskriminimit në trajtimin dhe në paraqitjen e të dhënave.

#### Neni 35

##### Shërbimi i të dhënave

Operatori publik i telekomunikacioneve, i cili ofron shërbim telefonik, është i detyruar të ofrojë shërbimin e të dhënave për të gjithë përdoruesit e vet.

Operatori publik i telekomunikacioneve, i cili ofron shërbim telefonik, duhet të ofrojë shërbimin e të dhënave edhe për përdoruesit e pajtuar pas publikimit të numërorit të fundit telefonik, nëpërmjet centralistes ose në forma të tjera.

Të dhënat në dispozicion të këtij shërbimi duhet të azhurnohen çdo muaj.

#### Neni 36

##### Ofrimi i të dhënave të klientëve

Për të ofruar shërbimin e të dhënave për publikun ose të publikimit të numërorëve telefonikë, operatori që ofron shërbime publike të telefonisë zanore duhet t'u japë të licencuarve të tjerë, të cilët ofrojnë shërbime të ngjashme me kërkesën e tyre dhe në një formë të përshtatshme për tru përdorur, akses në të dhënat e përdoruesve, duke mbikëqyrur zbatimin e rregullave për mbrojtjen e të dhënave.

Në këto raste, pagesa bazohet në koston që nevojitet për sigurimin e një shërbimi të frytshëm.

#### Neni 37

##### Shërbimet e urgjencës

Operatori publik i telekomunikacioneve, i cili ofron shërbime telefonike, duhet të sigurojë falas shërbimet e urgjencës. Shërbimi i urgjencës është vijimi i thirrjeve drejt numrave të shkurtër, të caktuar për organet përkatëse të shërbimeve të urgjencës si:

- a) forcat e policisë së shtetit;
- b) forcat e mbrojtjes nga zjarri;
- c) ndihma e shpejtë mjekësore.

#### Neni 38

##### Shërbimi i përgjithshëm

Këshilli i Ministrave bën klasifikimin dhe përcakton detyrimet për shërbimin e përgjithshëm në kuadër të politikave të zhvillimit të telekomunikacioneve, të cilat duhet

të synojnë që shërbimet të jenë të disponueshme dhe me çmime të përballueshme për të gjithë përdoruesit në territorin e tyre, pavarësisht nga vendndodhja gjeografike.

Shteti zbaton një politikë të veçantë për përballimin e shërbimeve telefonike në zonat rurale ose në zona me kosto të lartë, si dhe nga përdorues me aftësi të kufizuar ose me nevoja të veçanta shoqërore.

Detyrimet e operatorit për shërbimin e përgjithshëm, të përcaktuara në kushtet e licencës, derdhen në fondin e shërbimit të përgjithshëm, i cili administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Postë-Telekomunikacioneve.

## KREU IV

### SIGURIMI I RRJETIT TË HAPUR DHE INTERKONEKSIONI

#### Neni 39

Kërkesat thelbësore për sigurimin e rrjetit të hapur

Operatorët, për të garantuar funksionimin e frytshëm të rrjeteve dhe të shërbimeve të telekomunikacioneve, janë të detyruar të plotësojnë këto kërkesa thelbësore:

- a) sigurimin e funksionimit të rrjetit;
- b) ruajtjen e tërësisë së rrjetit;
- c) bashkëpunimin ndërmjet shërbimeve,
- ç) mbrojtjen e të dhënave.

#### Neni 40

Parimet bazë të sigurimit të rrjetit të hapur

Parimet dhe kushtet e harmonizuara për sigurimin e rrjetit të hapur duhet të mbështeten në kritere objektive, të jenë transparente dhe të publikuara në mënyrën e duhur, të garantojnë akses të barabartë dhe të mos jenë diskriminuese.

#### Neni 41

Ndërfaqet për sigurimin e rrjetit të hapur

Për sigurimin e rrjetit të hapur, Enti Rregullator i Telekomunikacioneve publikon standardet e ndërfaqeve teknike, të harmonizuara me standardet ndërkombëtare.

Sipas këtyre standardeve:

- a) kur një ofrues shërbimi zbaton këto standarde, ai përmbush kërkesat themelore;
- b) kur një operator telekomunikacionesh përmbush këto standarde, ai plotëson kërkesat për rrjet të hapur.

#### Neni 42

Detyrimet e organizmave me fuqi të ndjeshme në treg për interkoneksion

1. Organizmat me fuqi të ndjeshme në treg duhet:

- a) tru japin subjekteve, që kërkojnë interkoneksion, shërbime të njëjta, në kushte dhe në rrethana të njëjta;
  - b) tru japin operatorëve të tjerë pajisje dhe linja interkoneksioni së bashku me të dhënat përkatëse, me cilësi dhe tarifë të njëjtë me ato që ai ofron për shërbimet e veta dhe të filialeve, partnerëve ose ortakëve të tyre;
  - c) të sigurojnë, me përjashtim të rastit kur Enti Rregullator i Telekomunikacioneve parashikon ndryshe, të dhëna së bashku me specifikimet e nevojshme teknike për lidhjen e një marrëveshjeje interkoneksioni, si dhe të dhëna për zhvillimin e rrjetit në 6 muajt e ardhshëm;
  - ç) tri paraqesin detyrimisht Entit Rregullator të Telekomunikacioneve kopje të marrëveshjeve të tyre me kërkesën e tyre të interkoneksionit dhe, me kërkesën e tyre, trua vënë në dispozicion të tretëve. Enti Rregullator i Telekomunikacioneve mund të vendosë që të dhëna të rëndësishme, me natyrë tregtare, të mos jepen, me përjashtim të të dhënave për tarifatat dhe kushtet e interkoneksionit.
- Për shkelje të paragrafit të parë të këtij neni, Enti Rregullator i Telekomunikacioneve mund ta deklarojë marrëveshjen plotësisht ose pjesërisht të pavlefshme.
- Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit të parë, shkronja "a" të këtij neni, kushtet dhe tarifatat e vendosura për operatorët që zotërojnë rrjet mund të jenë të ndryshme nga ato për operatorët që nuk zotërojnë rrjet.

Neni 43

Marrëveshja e interkoneksionit

Marrëveshja e interkoneksionit është marrëveshje ndërmjet dy palëve, që përcakton kushtet teknike dhe financiare të realizimit të interkoneksionit. Një kopje e marrëveshjes së interkoneksionit i paraqitet Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.

Me marrjen e kërkesës, çdo organizëm me fuqi të ndjeshme në treg duhet tri japë kërkuarit një ofertë interkoneksioni.

Kur operatorët publikë të telekomunikacioneve nuk arrijnë të lidhin marrëveshje interkoneksioni brenda 2 muajve nga data e fillimit të bisedimeve, Enti Rregullator i Telekomunikacioneve, pasi shqyrton pretendimet e tyre, nxjerr urdhër me shkrim për lidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit brenda 1 muaji nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

Neni 44

Publikimi i kushteve të interkoneksionit

Organizmi me fuqi të ndjeshme në treg duhet të publikojë kushtet teknike dhe tarifatat e interkoneksionit.

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve, gjatë orarit të punës, duhet të vërë në dispozicion, pa pagesë, të palëve të treta të interesuara, marrëveshjet e interkoneksionit, me përjashtim të atyre pjesëve që kanë të bëjnë me strategjinë tregtare të palëve në marrëveshje. Enti Rregullator i Telekomunikacioneve përcakton se cilat pjesë të marrëveshjes së interkoneksionit quhen strategji tregtare e palëve.

Neni 45

Marrëveshjet antikonkurrence

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve ndërhyt që marrëveshjet për interkoneksionin të mos cenojnë parimet e konkurrencës në tregun e telekomunikacioneve.

Neni 46

Tarifat për interkoneksion

Tarifat e interkoneksionit duhet të jenë të orientuara drejt kostos së përdorimit të frytshëm të rrjetit.

Për përcaktimin e tarifave për interkoneksionin, nga organizmat me fuqi të ndjeshme në treg, do të zbatohen parime të njëjta me ato të përshkruara në nenet 60, 63, 64 dhe 65 të këtij ligji.

KREU V

LICENCIMI

Neni 47

Detyrimi për licencë

Asnjë person fizik ose juridik nuk mund të ofrojë shërbime publike telekomunikacionesh brenda Shqipërisë ose ndërmjet Shqipërisë dhe një vendi tjetër, pa qenë i pajisur me licencë të lëshuar sipas këtij ligji.

Neni 48

Klasifikimi i licencave

Në sektorin e telekomunikacioneve, licencat klasifikohen:

a) Licenca individuale;

b) Licenca të përgjithshme.

- Licencat individuale klasifikohen në 2 klasa:

Klasa I. Licenca individuale e klasës I jepet për shërbimet publike telefonike, të palëvizshme dhe të lëvizshme, në shkallë kombëtare. Numri i tyre përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Klasa II. Licenca individuale e klasës II jepet për shërbime publike telefonike në zonat rurale, shërbime radioje të kërkimit të personit, shërbime globale të komunikimeve vetjake të lëvizshme, dhe çdo shërbim tjetër, që përdor spektrin e radiofrekuencave.

- Licencat e përgjithshme jepen për ofrimin e aksesit në Internet, për shërbimet e transmetimit të të dhënave, për shërbimet me vlerë të shtuar, për shërbimet e telefonave publike me monedhë ose me kartë të parapaguar, si dhe për të gjitha shërbimet e tjera që nuk përmenden në klasën I dhe II të licencave individuale.

Këshilli i Ministrave bën klasifikimin e shërbimeve që mund të lindin në të ardhmen si rezultat i zhvillimit teknologjik.

Neni 49

#### Procedurat e licencimit

Licencat individuale të klasit I u jepen subjekteve që fitojnë tenderin e hapur ndërkombëtar.

Me propozimin e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve, Ministri i paraqet për miratim Këshillit të Ministrave kriteret dhe kushtet e dhënies së licencave individuale të klasit I, si dhe procedurat e zhvillimit të tenderit.

Fillimi i procedurave të tenderit për dhënien e licencave individuale të klasit I bëhet me urdhër të Ministrit.

Licencat individuale të klasit II dhe licencat e përgjithshme jepen brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës për licencë dhe kryerja e pagesave përkatëse.

Neni 50

#### Kriteret e marrjes së licencës

Çdo person fizik ose juridik mund të kërkojë dhe të vlerësohet i aftë për licencë, nëse autoriteti licencues gjykon se ai zotëron besueshmëri, frytshmëri dhe njohuri të specializuara.

Cilido që garanton:

- a) respektimin si i licencuar të dispozitave ligjore, vlerësohet se zotëron besueshmëri;
- b) disponueshmërinë e mjeteve për ngritjen e rrjetit dhe veprimin e tij, të nevojshme për të ushtruar të drejtat e licencës, vlerësohet se ka frytshmëri;
- c) njohuritë, përvojën dhe aftësitë e personave të angazhuar në ushtrimin e të drejtave të licencuarit, vlerësohet se zotëron njohuri të specializuara.

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve mund të kërkojë të dhëna dhe dëshmi që mbështesin kërkesën dhe mund të kundërshtojë dhënien e licencës, nëse të dhënat e kërkuarit nuk përmbushin kriteret e këtij neni.

Këshilli i Ministrave miraton kriteret për marrjen e licencave individuale të klasit I.

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve miraton kriteret për marrjen e licencave individuale të klasit II dhe të licencave të përgjithshme.

## Neni 51

### Dhënia e licencave

Licencat individuale të klasit I jepen nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve pas daljes së urdhrimit të Ministrit për shpalljen e fituesit.

Licencat individuale të klasit II dhe licencat e përgjithshme jepen nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve.

Licenca është e vlefshme për afatin e parashikuar në licencë dhe, ky afat, nuk mund të jetë mbi 25 vjet.

## Neni 52

### Kushtet e licencës

Licenca mund të përmbajë kushte për çështjet e mëposhtme:

1. Ofrimin e shërbimit në zonat rurale ose në ato me dendësi të rrallë populimi ose në zona të tjera të veçanta.
2. Ofrimin e shërbimit për personat me aftësi të kufizuar dhe nevoja të veçanta shoqërore.
3. Ofrimin e shërbimit të telefonise publike me monedhë ose kartë të parapaguar.
4. Zbatimin e kërkesave të veçanta për shërbime ndërkombëtare, siç janë detyrimet që rrjedhin nga nënshkrimi i traktateve, vendosja e pagesave ndërmjet operatorëve në nivel ndërkombëtar dhe procedurat e shlyerjes së këtyre pagesave, kërkesat e vijimit të trafikut etj.
5. Detyrimin për pagimin e tarifës së licencës.
6. Pagimin, nga i licencuari, të kontributeve për mbajtjen e fondit të shërbimit të përgjithshëm ose të një fondi të ngjashëm me të;
7. Interkonektimin e sistemit të të licencuarit me sisteme të tjera, ndërfunksionimin e shërbimeve të sistemeve të ndryshme dhe zgjidhjen, nëpërmjet Entit Rregullator të Telekomunikacioneve, të mosmarrëveshjeve ndërmjet operatorëve për këto çështje.
8. Detyrimin e të licencuarit për tru dhënë të dhëna Drejtorisë të Përgjithshme të Postë-Telekomunikacioneve dhe Entit Rregullator të Telekomunikacioneve, me qëllim që të verifikojnë përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj ose respektimin e kushteve të licencës.
9. Publikimin e tarifave, të kushteve të shërbimit dhe mënyrën e këtij publikimi.
10. Respektimin e kërkesave teknike dhe të standardeve të cilësisë.
11. Dhënien e të dhënave për operatorët ose aksesit për një shërbim të tillë dhe zgjidhjen nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve të mosmarrëveshjeve ndërmjet operatorëve, për bashkëpunimin në dhënien e të dhënave për numëratoret.
12. Detyrimin për dhënien e një numri minimal linjash me qira.
13. Mbajtjen e një sistemi të caktuar kontabiliteti.
14. Ofrimin e shërbimeve për konsumatorët dhe, në veçanti, respektimin e kushteve dhe/ose normave të etikës profesionale për këto shërbime.

15. Detyrimin për rregullimin e tarifave, kur i licencuari është organizëm me fuqi të ndjeshme në treg.
16. Lidhjen e pajisjeve të përdoruesit me rrjetin e të licencuarit.
17. Detyrimin për respektimin e rregulloreve në zbatim të nenit 57.
18. Detyrimin për ofrimin falas të thirrjeve të urgjencës.
19. Dhënien e aksesit Entit Rregullator të Telekomunikacioneve, për të marrë automatikisht të dhëna për efekt kontrolli.
20. Kërkesën për tru siguruar përdoruesve një njoftim të përshtatshëm për faturimin dhe tarifën.
21. Detyrimin për sigurimin kombëtar.
22. Detyrimin për mbajtjen e llogarive financiare të veçanta për biznesin ndërkombëtar.
23. Detyrimin për njoftimin për ndryshimin e strukturës së zotëruesve të aksioneve.
24. Detyrimin për të lidhur kontrata me përdoruesin për ofrimin e shërbimeve telefonike.
25. Detyrimin për ruajtjen për jo me pak se 2 vjet të faturave të përdoruesve të shërbimeve telefonike.

#### Neni 53

##### Njoftimi i ankesave të licencuarit

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve njofton të licencuarin për çdo ankesë në adresë të tij, me qëllim që tri japë atij mundësi të shpjegohet.

#### Neni 54

##### Mospranimi

Kërkesa për licencë mund të mospranohet kur Enti Rregullator i Telekomunikacioneve:

- a) nuk ka në dispozicion frekuenca, të cilat mund tri jepeshin kërkuesit që kërkon të përdorë pajisje radiokomunikacioni;
- b) ka prova të mjaftueshme se:
  - (i) kërkuesi i licencës nuk ka besueshmëri, frytshmëri dhe njohuri të specializura profesionale, që kërkohen për ushtrimin e licencës;
  - (ii) si rezultat i dhënies së licencës, rrezikohet rendi publik ose sigurimi kombëtar.

#### Neni 55

##### Ndryshimi dhe heqja e licencës

Licenca mund të ndryshohet, pezullohet ose hiqet në çdo kohë.

Për të mbrojtur interesin publik dhe për të arritur objektivat e politikës së zhvillimit të telekomunikacioneve, Enti Rregullator i Telekomunikacioneve mund të ndryshojë kushtet e licencës pas kryerjes së një procesi këshillimi.

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve mund të heqë licencën me nismën e vet ose në bazë të propozimit të inspektorëve të tij kur:

- a) pas dhënies së licencës vërtetohet se i licencuari, gjatë kërkesës për licencë, ka paraqitur të dhëna të rreme, të cilat vënë në dyshim zbatimin e kushteve të licencës;
- b) i licencuari ka shkelur dispozitat e këtij ligji;
- c) i licencuari nuk respekton kushtet e licencës;
- ç) i licencuari ka falimentuar ose është shlyer;
- d) i licencuari nuk ka bërë pagesën e licencës ose të tarifës së radiofrekuencave brenda 30 diteve nga afati i përcaktuar ose 15 ditë pas njoftimit të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.

Neni 56

#### Transferimi i licencës

Ndalohet çdo marrëveshje për tjetërsimin, dhënien si mjet sigurimi, dhënien me qira ose këmbimin e licencës pa miratimin paraprak me shkrim të autoritetit licencues.

Miratimi nuk duhet të vonohet pa arsye të fortë të motivuar.

Neni 57

#### Udhëzimet dhe rregulloret

Për të plotësuar kuadrin rregullator të përcaktuar nga ky ligj dhe nga aktet e tjera nënligjore në fuqi, Ministri mund të nxjerrë udhëzime për:

- a) publikimin e marrëveshjeve të interkoneksionit;
- b) zbatimin e procedurave për zgjedhjen dhe parazgjedhjen e operatorit, si dhe mundësinë e portabilitetit të numrit;
- c) përdorimin e përbashkët të pajisjeve dhe të aparaturave, duke përfshirë vendosjen e tyre në mjedise të përbashkëta;
- ç) respektimin e kërkesave themelore nga i licencuari, duke përfshirë sigurimin e funksionimit të rrjetit dhe ruajtjen e tërësisë së tij, ndërfunksionimin e shërbimeve, mbrojtjen e të dhënave, mbrojtjen e mjedisit, objektivat urbanistikë, në fshat dhe në qytet, përdorimin e spektrit të radiofrekuencave dhe shmangien e interferencave të dëmshme ndërmjet sistemeve të radiokomunikacioneve dhe sistemeve të tjera teknike, hapësinore ose tokësore;
- d) numëracionin dhe zbatimin e një skeme numëracioni, të përcaktuar nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve;
- dh) ndërfunksionimin e rrjeteve, për të siguruar cilësinë e shërbimit ndërmjet dy pikave fundore;
- e) përgjimin e komunikimeve në rrjetin e të licencuarit;
- ë) mbrojtjen e të dhënave të klienteve.

Në zbatim të këtij ligji, të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe të udhëzimeve të nxjerra në përputhje me paragrafin e parë të këtij neni, Enti Rregullator i

Telekomunikacioneve nxjerr rregulloret e nevojshme, të cilat janë të detyrueshme për tru zbatuar.

Rregulloret botohen në Buletinin e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.

## KREU VI

### RREGULLIMI I TARIFAVE

#### Neni 58

##### Përcaktimi i tarifave

Tarifat për shërbimet publike të telekomunikacioneve vendosen nga operatorët publikë të telekomunikacioneve dhe ofruesit e shërbimeve të telekomunikacioneve.

#### Neni 59

##### Kontrolli i tarifave

Tarifat e vendosura nga një organizëm me fuqi të ndjeshme në treg janë subjekt kontrolli. Mekanizmi dhe termat e kontrollit përcaktohen në licencë.

Kur Enti Rregullator i Telekomunikacioneve çmon se në treg ka konkurrencë të frytshme për një shërbim ose grup shërbimesh, që është objekt i kontrollit të tarifave, në bazë të kushteve të licencës ai i propozon Ministrit për të paraqitur në Këshillin e Ministrave aktin nënligjor përkatës, që përjashton kontrollin e tarifave për një shërbim ose grup shërbimesh.

Kur Enti Rregullator i Telekomunikacioneve çmon se konkurrenca për një shërbim ose grup shërbimesh në treg nuk është e mjaftueshme për të garantuar që tarifat të jenë të arsyeshme, Enti Rregullator i Telekomunikacioneve i propozon Ministrit për të paraqitur në Këshillin e Ministrave aktin nënligjor përkatës, që detyron zbatimin e kontrollit të tarifave mbi atë shërbim ose grup shërbimesh dhe cakton kushtet e kontrollit të tarifave. Kur një licencë përmban kushte për kontrollin e tarifave, dispozitat e ligjit nr. 8044, datë 7.12.1995 sPër konkurrencënt, zbatohen vetëm kur janë rrethanat e përcaktuara në paragrafin e dytë të këtij neni.

#### Neni 60

##### Kriteret që zbatohen për rregullimin e tarifave

Për organizmat me fuqi të ndjeshme në treg, tarifat duhet të orientohen drejt kostos së ofrimit të shërbimit të frytshëm dhe njëkohësisht, të lejojnë që i licencuari të realizojë një fitim të arsyeshëm, të jenë transparente dhe të publikuara në mënyrë të përshtatshme, të mos përmbajnë zbritje të cilat shmangin mundësitë konkurruese të operatorëve të tjerë në tregun e telekomunikacioneve, si dhe të mos jenë diskriminuese e të garantojnë trajtim të barabartë.

## Neni 61

### Publikimi

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve publikon një herë në vit në Buletinin e vet shërbimet dhe zonat përkatëse gjeografike, si dhe organizmat simotra me fuqi të ndjeshme në treg, ku ofruesit janë objekt i procedurave të rregullimit të tarifave.

## Neni 62

### Përcaktimi i metodologjisë për rregullimin e tarifave

Me propozimin e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve, Ministri i paraqet për miratim Këshillit të Ministrave metodologjinë për rregullimin e tarifave.

## Neni 63

### Procedurat rregullatore për tarifatat që janë objekt kontrolli

Çdo vit kalendarik Enti Rregullator i Telekomunikacioneve verifikon përputhshmërinë e tarifave të zbatuara nga operatorët për shërbimet që i nënshtrohen kontrollit të tarifave me metodologjinë e miratuar dhe publikon rezultatet e verifikimit. Nëse vëren shmangie, Enti Rregullator i Telekomunikacioneve merr masa dhe vendos afate për arritjen e përputhshmërisë së kërkuar.

Kur i licencuari kërkon të bëjë ndryshime tarifash, ai njofton, me shkrim Entin Rregullator të Telekomunikacioneve 60 dite para zbatimit të tarifave të reja.

I licencuari nuk duhet të ndryshojë tarifatat për përdoruesit jashtë metodologjisë dhe procedurave të miratuara.

## Neni 64

### Njoftimi i publikut

Për çdo ndryshim të tarifave, i licencuari detyrohet të njoftojë përdoruesit me anë të mjeteve të informimit publik, të paktën 15 ditë para hyrjes në fuqi të tarifave të reja dhe ky njoftim duhet të zgjasë jo më pak se 3 ditë rresht.

## Neni 65

### Ndalimi i zbatimit të tarifave shpërdoruese

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve duhet të ndalojë kryerjen e transaksioneve që përdorin tarifa, të cilat vijnë në kundërshtim me metodologjinë e rregullimit të tarifave.

## KREU VII

### NUMËRACIONI

#### Neni 66

##### Hartimi dhe administrimi i planit të numëracionit

Plani i numëracionit hartohet nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve. Enti Rregullator i Telekomunikacioneve është përgjegjës për strukturimin dhe konfigurimin e hapësirës së numëracionit për plotësimin në çdo kohë të kërkesave të operatorëve dhe të ofruesve të shërbimit. Elementet thelbësore të strukturimit dhe konfigurimit të planit të numëracionit duhet të botohen në Buletinin e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve. Enti Rregullator i Telekomunikacioneve bën administrimin e planit dhe caktimin e numrave për operatorët dhe ofruesit e shërbimit.

Caktimi i numrave nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve duhet të bëhet në kushte jodiskriminuese dhe të sigurojë një përdorim të frytshëm të tyre.

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve mund të vendosë kushte, të cilat duhet të plotësohen nga kërkuesi i numrave. Këto kushte, si dhe rregullat për caktimin e numrave, botohen në Buletinin e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.

#### Neni 67

##### Caktimi i numrave

Numrat caktohen në bazë të kërkesës së operatorit dhe të ofruesit të shërbimit, kundrejt një pagese të caktuar.

#### Neni 68

##### Ndryshimi i planit të numëracionit

Për përmbushjen e detyrimeve ose të rekomandimeve ndërkombëtare dhe për të siguruar sasi të kënaqshme të numrave, Enti Rregullator i Telekomunikacioneve mund të ndryshojë strukturën dhe konfigurimin e hapësirës së numëracionit, si dhe caktimin e numrave. Ndryshimet e propozuara bëhen të njohura para miratimit të tyre.

Operatorët dhe ofruesit e shërbimeve, që preken nga këto ndryshime, marrin të gjitha masat e duhura për zbatimin e tyre.

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve mund të marrë vendim për futjen e zgjedhjes dhe të parazgjedhjes së operatorit, për portabilitetin e numrit etj.

## KREU VIII

### RADIOKOMUNIKACIONET

#### Neni 69

##### Përdorimi i spektrit të radiofrekuencave

Spektri i radiofrekuencave, si një burim natyror i kufizuar, përdoret për të përmbushur nevojat e përdoruesve. Për sigurimin e përdorimit të frytshëm dhe pa interferenca të radiofrekuencave hartohet plani kombëtar i radiofrekuencave, si dhe mbikëqyren frekuencat e dhëna dhe përdorimi i tyre.

#### Neni 70

##### Plani kombëtar i radiofrekuencave

Plani kombëtar i radiofrekuencave ose ndryshimi i tij miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit. Hartimi i planit kombëtar të radiofrekuencave bashkërendohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Postë-Telekomunikacioneve. Gjatë hartimit të këtij plani bashkëpunohet me Entin Rregullator të Telekomunikacioneve dhe me institucionet shtetërore të ngarkuara për mbrojtjen kombëtare dhe për sigurimin e rendit publik, si dhe me KKRT-në.

Plani kombëtar i radiofrekuencave përmban shërbimet e radiokomunikacioneve për brezat përkatës. Për sigurimin e përdorimit të frytshëm dhe pa interferenca të radiofrekuencave, plani kombëtar i radiofrekuencave përmban edhe dispozita që udhëzojnë përdorimin e radiofrekuencave, si dhe përcaktime të tjera me të hollësishme.

#### Neni 71

##### Mbikëqyrja e spektrit të radiofrekuencave

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve mbikëqyr të gjithë spektrin e radiofrekuencave, për të shmangur interferencat dhe për sigurimin e funksionimit normal të shërbimeve.

#### Neni 72

##### Organet e administrimit të radiofrekuencave

Spektri i radiofrekuencave administrohet nga:

- a) Enti Rregullator i Telekomunikacioneve për brezat e radiofrekuencave të caktuara për qëllime civile, për përdorim publik ose privat, me përjashtim të brezit të frekuencave të caktuara për transmetime radio e televizive, të cilat administrohen nga KKRT-ja;

b) Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Rendit Publik dhe Shërbimi Informativ i Shtetit për brezat e radiofrekuencave të caktuara për mbrojtjen kombëtare.  
Për përdorimin e radiofrekuencave, përdoruesit civilë paguajnë një taksë, e cila përcaktohet me ligj të veçantë.

#### Neni 73

Bashkëpunimi ndërmjet organeve të administrimit të spektrit të radiofrekuencave

Me qëllim që të mbrohen shërbimet e radiokomunikacioneve, organet e administrimit të spektrit të radiofrekuencave detyrohen të këmbëjnë të dhëna për caktimin e radiofrekuencave në brezat përkatës, si dhe të bashkëpunojnë për të identifikuar e zbuluar transmetimet dhe interferencat e paautorizuara.

#### Neni 74

Rregullimi dhe administrimi i radiofrekuencave

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve administron spektrin e radiofrekuencave për qëllime civile me përjashtim të spektrit të radiofrekuencave që përdoren për transmetime radio e televizive dhe kryen rregullimet që lidhen me veprimtarinë e spektrit të radiofrekuencave për qëllime civile, në përputhje me parashikimet në këtë ligj. Rregullimet dhe veprimtaritë brenda sferës së radiokomunikacioneve duhet të përputhen me vendimet përkatëse të organizmave ndërkombëtarë dhe detyrimet që rrjedhin nga konventat ose nga marrëveshjet ku Republika e Shqipërisë është palë.

#### Neni 75

Dhënia dhe ndryshimi i radiofrekuencave

Dhënia e radiofrekuencave bëhet në përputhje me planin kombëtar të radiofrekuencave dhe me rregulloret e telekomunikacioneve në fuqi.

Radiofrekuencat për pajisjet dhe stacionet e radiokomunikacionit jepen:

- a) bashkë me licencën, kur kjo përmban radiofrekuencat përkatëse të punës;
- b) me lejen e përdorimit të radiofrekuencave për raste të tjera.

Në bazë të kërkesës, Enti Rregullator i Telekomunikacioneve ofron informacion për mundësitë e caktimit të radiofrekuencave për shërbimet e radiokomunikacioneve.

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve ofron të dhëna për stacionet e rrjetet ekzistuese ose të planifikuara të radiokomunikacioneve në brezat e radiofrekuencave dhe në zonat gjeografike përkatëse, me përjashtim të atyre për transmetime radio e televizive.

## Neni 76

### Mospranimi i dhënies së radiofrekuencës

Mospranimi i një procedure për dhënie radiofrekuence bëhet kur kushtet e përcaktuara për vendosjen e radiofrekuencës nuk zbatohen më ose kur ajo shihet e nevojshme nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve.  
Kur Enti Rregullator i Telekomunikacioneve e gjykon të arsyeshme, mund të bëhet ndryshimi i një radiofrekuence të dhënë.

## Neni 77

### Ndalimi i transferimit të radiofrekuencave të dhëna

Radiofrekuencat për qëllime civile, me përjashtim të frekuencave për transmetime radiotelevizive, jepen nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve dhe nuk i transmetohen të tretëve.

## Neni 78

### Prodhimi dhe përdorimi i pajisjeve të radiokomunikacioneve

Çdo person fizik ose juridik tregton, prodhon, vendos, zotëron ose përdor pajisje radiokomunikacioni, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

## Neni 79

### Përdorimi me licencë

Çdo pajisje radiokomunikacioni, me përjashtim të pajisjeve radio e televizive, vendoset dhe përdoret vetëm kur është dhënë licenca nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve për këtë qëllim ose në bazë të vendimeve të marra nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve.

Pajisja e radiokomunikacionit, për të cilën është dhënë një licencë nga autoritetet e huaja, mund të silltet e përdoret në Shqipëri për një kohë të shkurtër, pa ndonjë autorizim tjetër, në rast se një gjë e tillë përcaktohet në rregulloret ndërkombëtare të njohura e të pranuar nga Republika e Shqipërisë.

## Neni 80

### Kërkesa paraprake

Pajisjet e radiokomunikacioneve duhet të përdorin vetëm radiofrekuencat e përcaktuara në licencë.

Kushdo që përdor pajisje radiokomunikacioni duhet të sigurojë që nuk do të ndodhë asnjë interferencë e papranueshme me shërbimet e tjera radio, përfshirë këtu edhe marrjen e transmetimeve radiotelevizive.

Çdo licencë lëshohet pasi të jetë bërë miratimi i tipit të pajisjes, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Në raste të veçanta, Enti Rregullator i Telekomunikacioneve mund të lejojë vendosjen dhe përdorimin e një pajisje të tillë edhe pa qënë tip i miratuar.

## KREU IX

### MIRATIMI I TIPIT

#### Neni 81

##### Rregulloret teknike

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve përcakton kërkesat teknike që duhet të plotësojnë pajisjet fundore të telekomunikacioneve.

Kërkesat duhet të synojnë sigurimin e jetës të përdoruesve dhe shmangien e interferencave me rrjetet dhe sistemet e tjera të telekomunikacioneve, si dhe përdorimin e frytshëm të spektrit të radiofrekuencave.

#### Neni 82

##### Procedurat e miratimit të tipit

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve bën miratimin e tipit të pajisjes në rast se pajisja përputhet me standardet e paraqitura nga neni 16 ose me standarde të njëjta me të shteteve të tjera, me të cilat ka marrëveshje të njohjes ndërsjellë të miratimit të tipit.

Çdo subjekt, që prodhon, tregton ose importon pajisje fundore telekomunikacionesh në territorin e Republikës së Shqipërisë, duhet të marrë miratimin e tipit. Për këtë Enti Rregullator i Telekomunikacioneve publikon listën e pajisjeve që kërkojnë miratim.

#### Neni 83

##### Miratimet e përkohshme

Për pajisjet e telekomunikacioneve dhe radiokomunikacioneve me qëndrim të përkohshëm në Republikën e Shqipërisë, Enti Rregullator i Telekomunikacioneve bën miratim të përkohshëm të tipit me procedura të thjeshtuara.

## KREU X

## FUNKSIONIMI I ENTIT RREGULLATOR TË TELEKOMUNIKACIONEVE

### Neni 84

#### Statusi dhe Këshilli Drejtues i Entit Rregullator të Telekomunikacioneve

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve është person juridik, publik, jobuxhetor. Enti Rregullator i Telekomunikacioneve drejtohet nga Këshilli Drejtues, i cili është i pavarur në marrjen e vendimeve dhe funksionon në bazë të Rregullores së Brendshme, të miratuar nga ai vetë.

Selia e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve është në Tiranë.

Këshilli Drejtues përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët zgjidhen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Këshillit të Ministrave, për një periudhë 5 vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje jo më shumë se dy herë. Kuvendi cakton Kryetar njërin nga anëtarët e Këshillit Drejtues. Kryetari i Këshillit është drejtuesi ekzekutiv i Entit Rregullator i Telekomunikacioneve.

Anëtarët e Këshillit Drejtues duhet të jenë specialistë me arsim të lartë, të kualifikuar, të kenë të paktën 10 vjet përvojë pune dhe të përfaqësojnë sektorin e telekomunikacioneve, të ekonomisë, të drejtësisë dhe të administratës publike.

Çdo anëtar i Këshillit Drejtues përpara emërimit duhet të japë dorëheqjen nga çdo post ose funksion zyrtar, të terhiqet nga çdo veprimtari private fitimprurese, si dhe të shesë e të shlyejë çdo interes financiar që mund të ketë në shoqëri që ushtrojnë veprimtari tregtare nën juridiksionin e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.

Nuk mund të zgjidhet anëtar i Këshillit Drejtues:

- a) personi, bashkëshorti ose të afërmit deri në shkallë të dytë, që kanë lidhje me anëtarët e Këshillit të Ministrave;
- b) personi që është dënuar nga gjykata për kryerjen e një vepre penale me vendim të formes së prerë;
- c) personi që është debitor ose kreditor në një shoqëri, e cila i nënshtrohet kuadrit rregullator të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve;
- ç) personi që përjashtohet me ligj për të mbajtur poste publike shtetërore.

### Neni 85

#### Marrja e vendimeve dhe struktura e Këshillit Drejtues

Këshilli Drejtues merr vendimet me shumicë votash. Secili anëtar, duke përfshirë edhe Kryetarin, ka të drejtën e një vote. Asnjë vend bosh në Këshillin Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve nuk cenon të drejtën e anëtarëve që mbeten për të ushtruar të gjitha të drejtat e Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.

Në procesin e votimit nuk marrin pjesë anëtarët e Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve, kur vërtetohet një nga rastet e parashikuara në nenin 37 të Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë.

Pagat e anëtarëve të Këshillit Drejtues caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Këshilli Drejtues përcakton strukturën organizative, numrin dhe pagën e punonjësve të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.

Këshilli Drejtues vendos rregullat dhe kriteret e punësimit sipas ligjeve në fuqi.

## Neni 86

Lirimi dhe shkarkimi i anëtarëve të Këshillit Drejtues

Anëtari i Këshillit Drejtues lirohet ose shkarkohet nga organi që e ka zgjedhur kur:

- a) është në pamundësi fizike ose mendore për të kryer funksionet e ngarkuara;
- b) gjatë ushtrimit të detyrës është dënuar, nga gjykata, për kryerjen e një vepre penale me vendim të formës së prerë;
- c) emërohet punonjes në administratën shtetërore ose zgjidhet deputet i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë ose në organet e pushtetit vendor, me përjashtim të rastit kur është anëtar i shoqatave profesionale ose politike dhe mban funksione në to;
- ç) pa shkak të arsyeshëm nuk ka pranuar të kryeje ose nuk kryen detyrën ose është i paaftë për të ushtruar detyrën për një periudhë 6- mujore ose me shumë;
- d) përfshihet në ndonjerën nga dispozitat e nenit 84 të këtij ligji.

Kur një anëtar lirohet ose shkarkohet nga detyra, sipas paragrafit të parë të këtij neni, anëtari i ri emërohet nga organi përkatës, sipas nenit 84 të këtij ligji.

Çdo anëtar i liruar ose i shkarkuar nga detyra nuk ka të drejtë të rizgjidhet në Këshillin Drejtues.

## Neni 87

Financimi dhe buxheti i Entit Rregullator të Telekomunikacioneve

Burimet e financimit të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve janë tarifata e caktuara për përpunimin e aplikimeve dhe të kërkesave të ndryshme, sipas këtij ligji, si dhe pagesat për licencat e dhëna nga Entit Rregullator i Telekomunikacioneve.

Jo me vonë se tre muaj para fillimit të çdo viti financiar, Entit Rregullator i Telekomunikacioneve cakton një fond të shpenzimeve operative të parashikuara dhe ia paraqet për miratim Këshillit të Ministrave.

Entit Rregullator i Telekomunikacioneve mban llogari të plota dhe të sakta të shpenzimeve faktike, në përputhje me legjislacionin shqiptar të kontabilitetit.

Të gjitha të ardhurat e tepërta mbi shpenzimet e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve kalojnë në buxhetin e shtetit.

## Neni 88

Raportimi

Në përfundim të çdo viti, Entit Rregullator i Telekomunikacioneve i paraqet Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit raport për punën e bërë dhe programin e vitit pasardhës.

Gjatë vitit Enti Rregullator i Telekomunikacioneve jep të gjitha të dhënat që Ministri i gjykon të nevojshme për realizimin e objektivave të politikës së zhvillimit të telekomunikacioneve.

Neni 89

Publikimi

Dokumentacioni i skeduar i Entit Rregullator të Telekomunikacioneve është i hapur për publikun gjatë një kohë të caktuar brenda orarit zyrtar. Këto skeda përfshijnë dokumentacionin që indeksohet sipas udhëzimeve, procedurave dhe standardeve që cakton Këshilli Drejtues i Entit Rregullator të Telekomunikacioneve, duke respektuar parimin e ruajtjes së sekretit.

Dokumentacioni i rëndësishëm si kriteret e licencimit, procedurat, licencat e dhëna, rregullat e rregulloret teknike, standardet etj., publikohen në Buletinin e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.

KREU XI

PAGESAT

Neni 90

Llojet e pagesave

Kryhet me pagesë pranë Entit Rregullator të Telekomunikacioneve:

- a) përpunimi i kërkesave për licencim;
- b) dhënia e licencës;
- c) pagesë vjetore e licencës;
- ç) pajisja me numra;
- d) miratimi i tipit.

Pagesa për pikat sat, sbt, sçt dhe sdt bëhet vetëm njëherë, ndërsa pagesa për pikën sct çdo vit.

Neni 91

Përcaktimi i pagesave për licencat

Me propozimin e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve, Ministri i paraqet për miratim Këshillit të Ministrave masen e pagesave, të përcaktuara në nenin 90 të këtij ligji. Kriteri bazë në përcaktimin e nivelit të pagesave është mbulimi i kostos administrative të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.

## KREU XII

### INSPEKTIMI, MBIKËQYRJA DHE MASA ADMINISTRATIVE

#### Neni 92

##### Inspektimi

Inspektimi i veprimtarisë së të licencuarit kryhet nga inspektorët e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.

Inspektorët e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve pajisen me dokument të posaçëm identifikimi. Ata kryejnë inspektim në mjediset ku i licencuari zhvillon veprimtarinë edhe pa e njoftuar paraprakisht, për të verifikuar zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe të kushteve të parashikuara në licencën e dhënë.

I licencuari nuk ka të drejtë t'i ndalojë inspektorët për të kryer inspektimin dhe është i detyruar të bashkëpunojë me ta.

I licencuari është i detyruar tru japë të dhëna inspektorëve, kur ata e kërkojnë një gjë të tillë.

Inspektori, kur nevojitet ekspertizë e veçantë, mund të marrë ekspertë.

#### Neni 93

##### Bllokimi i pajisjeve

Inspektorët bllokojnë dhe të mbyllin me vulosje pajisjet, kur për përdorimin e tyre nuk është marrë ndonjë licencë, kur ato nuk janë të miratuara ose kur nuk plotësohen kërkesat e licencës.

Pajisjet e bllokuara inventarizohen dhe sekuestrohen me kalimin e afatit 1-mujor nga data e bllokimit dhe më pas i jepen për shitje subjekteve të ngarkuara me ligj. Pjesa e të ardhurave nga shitja, që rregullohet me kontratën përkatëse ndërmjet Entit Rregullator të Telekomunikacioneve dhe subjektit të mësipërm, kalon në buxhetin e shtetit.

#### Neni 94

##### Kundërvajtjet administrative

Kur inspektorët e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve vërtetojnë se i licencuari ka shkelur këtë ligj, kushtet e licencës dhe rregulloret e miratuara, kanë të drejtë:

a) të vendosin gjobë, në zbatim të nenit 96 të këtij ligji, dhe të kërkojnë nga i licencuari marrjen e masave për ndreqjen e shkeljes, duke vendosur afat për realizimin e saj;

b) tri propozojnë Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve ndalimin e veprimtarisë së të licencuarit;

c) tri propozojnë Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve heqjen e licencës.

Këshilli Drejtues i Entit Rregullator të Telekomunikacioneve, pasi shqyrton propozimin e inspektorëve në përputhje me shkronjat sht dhe sct të këtij neni:

(i) paralajmëron të licencuarin, me shkrim, duke përcaktuar shkeljen e bërë;

(ii) ndalon ose heq licencën individuale ose licencën e përgjithshme.

Për tri dhënë të licencuarit mundësi të japë mendime, para marrjes së vendimit për ndalimin ose heqjen e licencës, Enti Rregullator i Telekomunikacioneve njofton të licencuarin për vendimin dhe arsyet e marrjes së këtij vendimi.

Nëse edhe pas degjimit të të licencuarit, Enti Rregullator i Telekomunikacioneve e miraton marrjen e vendimit, ai i jep të licencuarit një kopje. Enti Rregullator i Telekomunikacioneve boton vendimin në Buletinin e vet dhe ndjek zbatimin e tij.

Neni 95

Ankimi

Për vendimet e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve që ndalojnë, heqin ose ndryshojnë kushtet e licencës mund të bëhet ankesë pranë Ministrit, brenda 10 ditëve nga shpallja e vendimit. Ministri, brenda 30 ditëve nga data e ankimit, vendos për ankimin e bërë.

Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu "Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative".

Neni 96

Gjobat

Shkeljet e mëposhtme, të kryera nga të licencuarit, kur nuk përbëjnë vepër penale, janë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

1. Me gjobë nga 30 000 deri në 50 000 lekë për rastet kur vërehen:

a) të dhëna të rreme ose mosdhënie të dhënash, të kërkuara nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Postë-Telekomunikacioneve, sipas nenit 19 të këtij ligji;

b) vëniet në punë të një stacioni radiokomunikimi pa marrë licencë, sipas nenit 79;

c) tregtimi i pajisjeve të telekomunikacioneve pa marrë miratimin e tipit, sipas nenit 82.

2. Me gjobë nga 250 000 deri në 1 000 000 lekë për rastet kur:

a) palët e treta, me pakujdesi mund të dëmtojnë nyjet, linjat, stacionet transmetuese dhe ndonje pajisje tjetër telekomunikacionesh, në kundërshtim me nenin 14. Në këtë rast, keta

të fundit detyrohen të zhduken të gjitha shpenzimet që bëhen për të sjelle pajisjet në gjendjen e mëparshme;

b) nuk i jepet përparësi transmetimit të mesazheve, që kanë të bëjnë me përballimin e fatkeqësive natyrore dhe me sigurimin e mbrojtjes kombëtare dhe të rendit publik, sipas nenit 20 dhe nenit 26;

c) shkelet neni 24 ose neni 25;

ç) shkaktohet interferencave nga operimi i një stacioni radioje dhe/ose operimi i pajisjeve të radiokomunikimit në frekuenca të ndryshme nga ato të përcaktuara në licencë, sipas nenit 80;

d) ndalohet hyrja e inspektorëve në mjediset ku janë vendosur pajisjet e telekomunikacioneve ose kur nuk jepet informacioni i nevojshëm, sipas nenit 90;

dh) dëmtohet shëndeti i përdoruesve dhe ndotet mjedisi, sipas nenit 32;

e) shkelet neni 34;

ë) investitorët ndërtues shkelin nenin 15.

3. Me gjobë nga 1 000 000 deri në 10 000 000 lekë për rastet kur:

a) operon në një rrjet publik telekomunikacionesh ose ofron shërbime publike të telekomunikacioneve bëhet pa u pajisur me licencë, sipas nenit 47;

b) nuk sigurohet mbrojtja e sekretit të mesazheve ose komunikimi i përmbajtjes së tyre personave të paautorizuar, sipas nenit 22;

c) kundërshtohet urdhri i Entit Rregullator të Telekomunikacioneve për interkoneksion, sipas nenit 43;

ç) ofrohen tarifa në kundërshtim me metodologjinë e tarifave, sipas nenit 63;

d) cenohet sekreti profesional, sipas nenit 23.

Kundër vendimit të dënimit me gjobë inspektori përkatës bëhet ankimi në Këshillin Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve brenda 10 ditëve nga data e dhënies së tij. Këshilli Drejtues i Entit Rregullator të Telekomunikacioneve merr vendim brenda 30 ditëve nga data e dhënies së gjobës.

Kundër vendimit të dënimit me gjobë mund të bëhet ankimi, brenda 5 ditëve nga data e shpalljes ose e njoftimit në gjykatën e rrethit ku është kryer kundërvajtja.

Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative, ankimi dhe ekzekutimi i vendimeve bëhet sipas ligjit nr., datë sPër kundërvajtjet administrative me ndryshimet e plotësimet e mëvonshme.

Gjopa është titull ekzekutiv që vilet nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve dhe derdhet në buxhetin e shtetit.

Neni 97

Bashkëpunimi me organet e tjera

Për ushtrimin e të drejtave, që burojnë nga ky ligj, Enti Rregullator i Telekomunikacioneve duhet të mbështetet nga autoritetet publike vendore dhe ato policore.

## KREU XIII

### DISPOZITA KALIMTARE TË FUNDIT

## Neni 98

### Vazhdimësia e funksionimit të Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve

Këshilli Drejtues i Entit Rregullator i Telekomunikacioneve, i emëruar sipas ligjit nr. 8288, datë 18.2.1998, sPër Entin Rregullator të Telekomunikacioneve, vazhdon të funksionojë edhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Anëtarët e tij vazhdojnë të qendrojnë në detyrë brenda afatit të caktuar në mandatin e emërimit. Llogaritja e afatit të mandatit bëhet duke filluar nga data e emërimit të tyre.

Vendimet dhe urdhrat e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve ose të Ministrit dhe të gjitha licencat e lëshuara, në mbështetje të ligjit nr. 8038, datë 23.11.1995, sPër telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë, të ligjit nr. 8287, datë 18.2.1998, sPër disa ndryshime në ligjin nr. 8038, datë 23.11.1995, "Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë ose të ligjit nr. 8288, datë 18.2.1998, sPër Entin Rregullator të Telekomunikacioneve, mbeten në fuqi dhe veprojnë, pavarësisht nga shfuqizimi i këtyre ligjeve, deri në çastin e ndryshimit të tyre në përputhje me kërkesat e këtij ligji, por jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

## Neni 99

### Shfuqizime

Ligji nr. 8038, datë 23.11.1995, sPër telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë", ligji nr. 8287, datë 18.2.1998, sPër disa ndryshime në ligjin nr.8038, datë 23.11.1995, "Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë" dhe ligji nr. 8288, datë 18.2.1998, sPër Entin Rregullator të Telekomunikacioneve, shfuqizohen.

Pika 4, e nenit 3, të ligjit nr. 7973, datë 26.7.1995, sPër koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturët, shfuqizohet.

## Neni 100

### Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**K R Y E T A R I**

Skendër Gjinushi

**VENDIM**

**Nr. 465 datë 19.7.2001**

**PER**

**METODOLOGJINE E RREGULLIMIT TE TARIFAVE TE  
OPERATORIT PUBLIK TE TELEKOMUNIKACIONEVE, TE.  
ALBTELECOM, SHA-së**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të 'neneve 59 dhe 62, të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000, "Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Metodologjia për rregullimin e tarifave të shërbimeve telefonike të qëndrueshme dhe të shërbimit të linjave me qira, të ofruara nga operatorë publik i telekomunikacioneve, të. Albtelecom, sha-së, cilësuar nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve si organizëm me fuqi të ndjeshme në treg, të jetë mekanizmi i cmimit tavan, sipas formulës që më poshtë vijon:

$T_i = T_{i-1} (1 + I - X + Z)$ ,

ku:

$T_i$ - tarifa për një minutë shërbimi telefonik ose tarifë shërbimi për vitin "i";

$T_{i-1}$  - tarifa për një minutë shërbimi telefonik ose tarifë shërbimi për vitin paraardhës;

I-treguesi i inflacionit të vitit paraardhës në %, i raportuar nga Instituti i Statistikës;

X- faktori i'përmirësimit të frytshmërisë së operatorit, në %;

Z- faktori rregullues i tarifës, në %

Vlerat e X dhe Z jepen në lidhjen nr. 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shportat e shërbimeve për cdo vit dhe rregullimi mesatar, tavan, i tyre të jenë ato të lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Vlera e shportës së shërbimeve të cdo viti të llogaritet në bazë të trafikut në minuta, të kryer në

vitin paraardhës, dhe të mesatares së tarifave të këtij viti dhe atyre të vitit llogaritës, ponderuar me trafikun në minuta, të realizuar në vitin paraardhës. Tarifat përkatëse të zërave të shërbimeve brenda cdo shporte nuk duhet të jenë më të larta se ato të përcaktuara sipas formulës së pikës 1 të këtij vendimi.

3. Rregullimi i tarifave në përputhje me këtë vendim të bëhet për aq kohë sa Albtelecom, sha-ja, të cilësohet organizëm me fuqi të ndjeshme në treg. Tarifat e reja të hyjnë në fuqi në fillim të cdo viti kalendarik. Për vitin 2001 ndryshimi i tarifave të bëhet në datën 1 gusht.

4. Albtelecom, sha-ja, të përcaktojë koston e plotë të cdo zëri shërbimi. Në përputhje me këto kosto dhe për rregullimin e tarifave të Albtelecom, sha-së, në vazhdimësi, Enti Rregullator i Telekomunikacioneve, jo më vonë se 5 vjet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të propozojë amendimet përkatëse në lidhjet nr. 1 dhe nr.2, të këtij vendimi.

5. Në strukturën e re tarifore, Albtelecom, sha-ja,:

a) të zbatojë:

i) për përdoruesit e kategorisë "Familjarë", shkallëzimin e impulseve me cmim pa TVSH, si më poshtë:

0- 1 50 impulse 1 lekë

mbi 150 impulse 4 lekë.

ii) për përdoruesit e kategorisë "Të tjerë" cmimin pa TVSH për cdo impuls 7 lekë.

b) të zbatojë ndryshimin e tarifave sipas pikës 1 të këtij vendimi, nëpërmjet ndryshimit të ritmit të impulseve të tarifimit.

c) të zbatojë breza orare për të gjitha llojet e bisedave.

6. Albtelecom, sha-ja, të zbatojë zbritje në pagesat e përdoruesve në masën 2.5 për qind kur shuma në faturën mujore të jetë mbi 1 500 lekë, për përdoruesit e kategorisë "Familjarë", dhe mbi 15 000 lekë, për përdoruesit e kategorisë "Të tjerë".

7. Ngarkohet Enti Rregullator i Telekomunikacioneve për zbatimin e këtij vendimi dhe për nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI  
ILIR META

MINISTRI I EKONOMISE PUBLIKE  
DHE PRIVATIZIMIT  
MUSTAFA MUCI

Lidhja 1. VLERAT E X DHE Z NE FORMULEN E CMIMIT TAVAN

Për të gjitha shërbimet X 2.5 %

A. Shërbime telefonike të qëndrueshme Z (%) për tarifën e Z (%) për tarifën e shportës Familjare shportës Të tjerë

Tarifë e instalimit 3.4 -13.1

Pajtim mujor 27.1 11.0

Tarifa e pikut (1 minutë)

Bisedë lokale brenda zonës urbane dhe 44.0 34.7

Komunës

Bisedë kombëtare:

në distancë deri 25 km 0.4 - 2.6

në distancë 25 - 50 km -9.1 -11.9

në distancë 50 - 100 km -10.9 -15.6

në distancë mbi 100 km -17.7 -21.3

Tarifa e zakonshme (1 minutë)

Bisedë lokale brenda zonës urbane dhe 19.0 33.1

komunës

Bisedë kombëtare:

në distancë deri 25 km 0.3 - 1.2

në distancë 25 - 50 km - 9.1 -10.4

në distancë 50 - 100 km -12.2 -14.8

në distancë mbi 100 km -18.1 -19.6

Tarifa e reduktuar (1 minutë)

Bisedë lokale brenda zonës urbane dhe 10.3 8.8

komunës

Bisedë kombëtare:

në distancë deri 25 km - 3.3 - 2.0

në distancë 25 - 50 km -12.4 -11.3

në distancë 50 - 100 km -16.5 -15.4

në distancë mbi 100 km -22.4 -20.2

Tarifa ndërkombëtare piku (1 minutë)

Bisedë me vendet fqinje 2.2 2.2

Bisedë me Europën, zona 1 1.5 1.5

Bisedë me Europën, zona 2 2.2 2.2

Bisedë me vendet e tjera 0.8 0.8

Tarifa ndërkombëtare e reduktuar (1 minutë)

Bisedë me vendet fqinje -2.4 -2.4  
Bisedë me Europën, zona 1 -2.5 -2.5  
Bisedë me Europën, zona 2 -2.1 -2.1  
Bisedë me vendet e tjera -1.9 -1.9

### 3. Shërbime të linjave me qera Z% për tarifrat e shportës Linja me qera

#### 1. Linja me qera kombëtare

Tarifa e instalimit për linja 64 kbit/s 126.4

2 Mbit/s 403.0

Pajtimi mujor për linja 64 kbit/s

dhe distanca: deri 25 km -58

25 - 50 km -69.2

50 - 100 km -69.0

mbi 100 km -65.7

Pajtimi mujor për linja 2 Mbit/s

dhe distanca: deri 25 km -66.4

25 - 50 km. -80.2

50 - 100 km -73.8

mbi 100 km -76.5

#### 2. Linja me qera ndërkombëtare

Tarifa e instalimit për linja 64 kbit/s -52.7

512 kbit/s -54.3

2 Mbit/s -46.8

Pajtimi mujor për

Vendet fqinje

për linja 64 kbit/s -47.2

512 kbit/s -42.8

2 Mbit/s -31.9

Europën, zonat

64 kbit/s -52.5

512 kbit/s -48.2

2 Mbit/s -38.5

Europën, zona 2

64 kbit/s -43.3

512 kbit/s -37.8

2 Mbit/s -29.1

Vendet e tjera

64 kbit/s -47.0

512 kbit/s -41.8

2 Mbit/s -33.7

## Lidhja 2. SHPORTAT E, SHERBIMEVE DHE RREGULLIMI TAVAN.

1. Shportat dhe kategoritë e shërbimeve për cdo shportë janë:

a) shporta e shërbimeve telefonike të qëndrueshme për kategorinë "Familjarë": pajtim, instalim, bisedë lokale kombëtare dhe ndërkombëtare;

b) shporta e shërbimeve telefonike të qëndrueshme për kategorinë "Të tjerë": pajtim, instalim, bisedë lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare;

c) shporta e shërbimeve për Linja me Qera: pajtim dhe instalim linjash kombëtare dhe ndërkombëtare.

2. Rregullimi mesatar vjetor tavan i vlerave të shportave të shërbimeve për periudhën e rregullimit 2001-2005 jepet në tabelën e mëposhtme:

Shporta Rregullimi mesatar vjetor tavan i shportës

Familjare -1.6

Të tjerë -0.4 %

Linja me qera -13 %

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
Këshilli i Ministrave

**VENDIM**

**Nr.573 datë 22/10/2001**

**PER**

**NJE NDRYSHIM NE VENDIMIN NR.83, DATT 26.2.2001, TE  
KISHILLIT TE MINISTRAVE, "PER TARIFAT TELEFONIKE  
DHE PER PAGESAT ELEKTRIKE NGA PERSONAT ME AFTESI  
TE KUFIZUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18, të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000, "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të nenit 12, të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbërit", si dhe të nenit 38, të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000, "Për telekomunikacionin në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Pika 3 , e vendimit nr.83, datë 26.2.2001, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

"3. Çdo përdorues me aftësi të kufizuara, që ka përfituar statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik ose statusin e të verbërit, paguan 20 për qind të vlerës së konsumit mujor të energjisë elektrike."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare" dhe i shtrin efektet që nga data e hyrjes në fuqi të vendimit nr.83, datë 26.2.2001, të Këshillit të Ministrave.

**KRYEMINISTRI**

**ILIR META**

**MINISTRI I EKONOMISE PUBLIKE  
DHE PRIVATIZIMIT**

**MUSTAFA MUCI**

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
Këshilli i Ministrave

VENDIM

Nr. 83 datë 26.2.2001

PER

TARIFAT TELEFONIKE DHE PER PAGESAT ELEKTRIKE NGA  
PERSONAT ME AFTESI TE KUFIZUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 12, të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000, "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të nenit 12, të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbërit", si dhe të nenit 38, të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000, "Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Cdo përdorues me aftësi të kufizuar ku përfshihet:

- a. invalidi paraplegjik dhe tetraplegjik;
- b. i verbëri, i paaftë për të lëvizur pa shoqërues, në kushte fizike të invaliditetit të grupit të parë,

përfiton 700 impulse në muaj me tarifa telefonike të nivelit të parë, të favorizuar për popullsinë.

2. Këto impulse clirohen nga tatimi dhe nga cdo ngarkesë tjetër.

Diferencat do t'i paguhen "Albtelecom"-it nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Cdo përdorues me aftësi të kufizuar, sipas pikës 1, paguan 20 për qind të vlerës së konsumit mujor të energjisë.elektrike.

Diferencat do t'i paguhen KESH-it nga fondi rezervd i Këshillit të Ministrave.

4. Ngarkohen Ministria e Punës dhe Cështjeve Sociale, Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministria e Shëndetësisë të nxjerrin një udhëzim të përbashkët për modalitetet e marrëdhënieve mes përfituesve dhe institucioneve ofruese.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI  
ILIR META

MINISTRI I EKONOMISE PUBLIKE  
DHE PRIVATIZIMIT

MUSTAFA MUCI